

ROMEO ÇOLAKU
ZEMER
VIRAJINE

poezi

BIBLIOTEKA

844-1
C22




884-1
272

ROMEO ÇOLLAKU

ZEMËR VIRGJINE

Poezi



Botimet TOENA
Tiranë 1993

UVERTURË

Gëzimi i gjertanishëm mu ktheftë në gjëmë,
Në ulërima vaji mu ktheftë ç'do këngë,

Pasioni sublim mu ktheftë në vdekje,
Shtëpia ku rroj më zëntë nën vete,

Vargjet e mia u bëfshin shigjeta,
Tabelë për to të më bëhet zemra,

Dhe gazet e moshës mu kthefshin në lotë,
Nëse rrugën që po nis në fund s'e çoj dot!

RA NJË PEMË

Ra një pemë e ngriti pluhur,
E mjegulloi pamjen përreth,
Shumë zogj të vegjël nën degë humbën
E dhanë shpirtin ata nën degë.

Ata të vegjlit atje mbenë,
Të mëdhenjtë fluturuan,
Ky shi që bie përmbi pemë
Eshtë lot i zogjve që shpëtuan.

ELEGJI PËR FËMIJËRINË

Ja, po të lëmë fëmijëri.
Të lëmë përgjithnjë,
Të prapë kemi qenë-e di,
Por nuk do jemi më.

Pa ne do duken si të shkreta
Rrugicëzat e ngushta,
Molla, qershia dhe pjeshka
Do ngjajnë si vejusha.

Të thuash fajet që kemi bërë
Është e vështirë,
Po na i fale ti të tëra
Me shpirtin tënd të mirë.

Të mallëngjer po ikim ne,
Dallgësh për tu futur,
Oh, lotët mos na i vë re —
Ke qenë moshë e bukur.

KUR JAM VETËM

Kur jam vetëm,
Kur ty s'të kam pranë,
Bota më duket e madhe
Dhe vetja humbak mes madhështisë,
Kur jam vetëm,
Humbas edhe veten
Pasi të kam humbur ty për atë çast
Dhe pa të fituar ty
Veten s'e gjej dot.
Mjafton të kem ty pranë
Dhe bota e madhe
Ku humbisja i vetëmuar
Për mua të mos ekzistojë,
Vetëm ty—
Sa shumë u dashka që të mohohet bota!

NJË VAJZË NË DRITARE

Një vajzë rri trishtueshmë në dritare,
Ku shiu i vjeshtës troket me furi,
Vështrimin tret kujtimesh mundimitare
Tek ajo rrugë nga ku askush s'do të vijë,

Nën trokun e shiut ajo qëndron përhumbur,
As qesh, as qan, as hesht, as bën zë,
Asgjë nuk mund t'i zgjojë sytë e saj të ngulur
Në rrugën pa njeri sikur sheh atje dikë.

POTHUAJSE NJË PËRALLË

Ne ishim të lumtur. U ndamë...
(Oh, ç'ish ky fund tragjik!)
Të ndjerët gjyshërit tanë,
U zunë dikur për një fik.

Ne ishim të lumtur. U ndamë;;
(Oh, ç'ish kjo marrëzi!)
Të ndjerët gjyshërit tanë
Në varre prehen tani.

ULLIRI NË VJESHTË

Ca gjethe bien tej në udhë,
Njëra pas tjetrës mengadalë
Dhe dallandyshet zhduken tutje
Verën duke mbajtë mbi krahë.

Tetori gjithë shira hyri,
U vyshkën lulet e u tretën,
Veç diku tej bleron ulliri
Dhe s'do të dijë që është vjeshtë.

SYTÈ

Sy, sy; sy; anembanë,
Sy të kaltër, sy të zezë, sy të bardhë,
Sy që hapen, sy që mbyllen, hapen, mbyllen
pareshetur,
Sy të ndjeshëm, sy të mistershëm, sy të zhveshur,
Hapen për të parë dhe si shohin mbyllen
Poshtë qepallave, portave të tyre
Dhe puliten, kështu ndodh kur kryqëzohen
ndonjëherë,
Sytë e bardhë me të kaltrit, të kaltrit me të zestë,
Sy-pasqyra të shpirtrave njerzorë,
Zbukurues të tyre, të tyre tradhëtorë.

TEK KY STOL

Ja, ku erdha prap tek ky stol buzë detit,
Ku kujtime, ëndrra, brenga janë mbleksur mos
më keq,
Atëherë s'e pashë mirë se sytë më kishin mbetur
Tek diçka më e bukur që më magjepsi si për dreq.

Atëherë jo stol, po asgjë tjetër s'pashë,
As lule, as shkëmbinj, as pulëbardhat
përmbi det,
Çdo bukuri që shkrirë në imazhin
e një vajze,
Atë e kisha pranë, ndaj s'shihja gjë përreth.

Ja ku erdha buzë detit, tek ky stol përsëri,
Sytë i'a kam ngulur, mendimet pas më venë,
Atëherë s'e pashë mirë, por ja, e shoh tani—
Kujtime, ëndrra, brenga mbleksur atje flenë.

Në kaltërsinë e asaj dite prap sot mrekullohem
Më kujtohet një fjalë, në letër hedh një varg,
Afrohem tek stoli, afrohem e afrohem,
Por nuk guxoj të ulem, ndaj kthehem, iki larg.

SHALLI I KUQ

Ka kohë, ai shall në sytë e mi
Nuk pasqyrohet, ka ditë që mungon,
Një dhimbje ndjej sot në vend të tij,
Një plagë të thellë sa një hon.

S'e shërojnë atë plagë dot as lotët,
Qofshin të pastër, kulluar si kristali,
Oh, njeriu qenka kaq i dobët
Sa plagoset nga mungesa e një shalli!

PËRVEÇ MEJE

Ajo ishte shtatëmbëdhjetë vjeç,
E lartë deri tek supi im,
Kishte një emër të gjatë me tetë shkronja,
Floket i kishte të zeza,
Sytë po ashtu, të zinj.

Sa herë që e thërrisin në emrin e gjatë me
tetë shkronja
Të gjithë ngatërroheshin,
Përveç meje.

SYRI YT

Syri yt—
Pafundësi e kaltër,
Galaktikë e tërë,
E thellë dhe e gjërë.
Qiell
Ku flatroj çdo ditë,
Det
Ku rrezik të mbytem.

NETË PA ËNDERRA

Sërish ne shihemi çdo ditë
(A shkon shikimi gjer në shpirt?)

Pra, si dhe më parë shihemi befasisht
Dhe ulim sytë për tokë sërisht.

Nuk flasim. Ashtu si at'herë
Kur u ruheshim syve të tjerë.

E pra asgjë s'paska ndryshuar, asgjë,
Veç kur vjen nata ëndrra s'shohim më.

PËRKUJDESJA E ZOTIT

Ku je kaq kohë që s'të kam parë,
Ku ke humbur kësaj gjeografie?
Brenda meje e bardhë-e bardhë
Dëbora e harrimit po bie.

S'na përplasen askund dallgët e jetës,
Larg njëri-tjetrit mbetëm përgjithnjë,
A thua përkujdeset Zoti vetë,
Që plagët e vjetra të mos hapen më?



XHELOZI STINËSH

Si një qilim i verdhë shtrihet
I ftohtë, i trishtë sot ky shesh,
Unë dua gjethet të mos bien,
Por ato bien vjeshtë për vjeshtë.

Tek sheh fuqinë e pranverës
Nuk e frenon dot xhelozinë,
Vjeshta e shiut dhe erës
Do vetëm zverdhje, jo blerim.

I zhvesh gjithë pemët, pastaj ikën,
Lakuriq krejt e lë botën,
Për t'i zënë vendin është në pritje,
Dimri, xheloz mbi xhelozë.

PËR PLEQTË

Pleqtë flenë,
Dremisin pa u ndjerë,
Sa tē dridhet zemra:
 Janë gjallë apo kanë vdekur?
Jo, ata flenë,
Flenë duke imituar vdekjen.
Kaq përsosur e imitojnë
Saqë po tē ndodhë tē vdesë njëri prej tyre,
Neve nuk na besohet,
U themi tē vegjëlve:
 Shsht, po fle gjyshi!

FËMIJËVE SHQIPTARË
MË 1 QERSHOR 1992

Asnjë vitrinë s'u zbukurua për ju,
ditën e 1 qershorit;
Asnjë balonë s'u ngrit në qiellin e gjërë,
Çdo prind një mospërfillje kundrejt
kalendarit trilloi,
Gazi juaj mbretëri e humbur nën rërë.

KOHA

Ai sapo vdiq, ndërroi jetë,
Ndërsa ora në dorën e tij vazhdon të ecë.

RA DHE GJETHI I FUNDIT

Në kopsht ra dhe gjethi i fundit,
Rrugën mori tanë vjeshta,
Si vejushë duken drurët
Pa një zog, pa një gjeth.

Diku, shtegut ku shkojnë vetëm stinët
Ajo me dimrin do ndërrojë turnin
Dhe sipas rregullores së tyre
Në proçes-verbalin e vitit do nënshkruajnë.

Stinët s'nënshkruajnë si njerëzit,
Prandaj atje në proçes-verbal
Vjeshta do të lërë të fundit gjeth,
Kurse dimri të parin kristal.

KËNGË SHIU

Pa thënë asnje fjalë ti ike
Dhe nuk le pas imazhin tënd,
Veç shiu nën ritmin arkaik
Për ty këndoi një këngë.

Sa herë që qielli hedh shi,
Më duket sikur shiu këndon
Atë këngën e dikurshme, ndërsa ti...
Ti ikën, ti ikën gjithmonë.

E PASHË FYTYRËN TËNDE

E pashë fytyrën tënde,
Dy liqene të thellë, të kulluar sytë e tu,
Vetullat — dy urëza mbi liqene,
Buzët e tua— petale trëndafili të vesuar...

E pashë fytyrën tënde
Dhe më erdhi keq
Që ti s'je e bukur si ajo.

GJIMNAZISTJA

Kur ajo kalon e vetme mbasditeve në rrugë,
Me një bukë a me çantën e ushqimeve në duar,
Në përparësen e zezë, si luftëtari pa parzmor
Duket më i rritur, duket më e bukur.
E shumëfishuar në retina sysh,
E skuqur nga batutat standart të djemve,
Ul kokën, fsheh fytyrën mës flokësh
Për bukurinë e saj e penduar.

NË ASNJË VJERSHË...

Në asnjë vjershë emrin s'ta kam shkruar,
Madje as inicialet,
Kam èndërruar që të paktën një herë
Sytë të t'i quaj liqene,
Flokët rreze të rrëmbyera diellit,
Por u frika mos gjithë vajzat sykaltra

e flokëverdha
Do të shiheshin përgjithmonë me dyshim.
Shkrova se të kam dashur shumë. Vetëm kaq.
E munda veten dhe emrin s'ta përmenda kurrë
E ti mos i kij zili të dashurat e poetëve të
tjerë,
Meri Morisonin, Ana Kernën, Z.B-në,
Nëse me emra a iniciale njihen nga të gjithë,
Për fatin tënd të keq dhe për mjerim
të kësaj bote

Ti duhet të shkosh tek lexuesit e paemër...
Ndoshta më mirë kështu;
Në mungesë të emrit tënd gjithësecili prej tyre
Do të vendosë emrin e të dashurës së vet.

KËNGË

I

Si të të quaj nuk e di,
Se ç'dreqin je për mua,
S'kam njohur më njeri si ty,
Me lodërzat e tua.

Ti je dinake krejt naive,
E afërt dhe e huaj,
Je gazi im dhe brenga ime,
Ndaj s'di si të të quaj.

II

Dua të eci vetëm rrugës,
Dhe të mendoj për ty,
Si dhe për çastet që më humbën
Diku në shkretëti.

Dua të eci vetëm rrugës,
I vetëm sot të rri
Dhe le t'm'i sjellë era e jugës
Mendimet gjer tek ty.

Dua të eci vetëm rrugës
Dhe të mendoj me mall
Për ty, për çastet që më humbën;
Do ktheheni ju vallë?

III

Ku je dhe ç'bën ti këtë çast,
Ç'farë èndrrash thur a ç'po kujton,
Në shpirtin tënd trishtimi, gazi
A qetësia mbretëron?

Dhe kë, kë vallë sjell ndërmend,
Ndërsa mbrëmja zë afrohet,
Ç'fytyrë aty në trurin tënd
Ka fatin të skicohet?

Më thuaj pra, ndër èndërrime
Në tru, në sy ç'fytyrë tu shfaq?
Nëse thërras: Fytyra ime!
S'besoj se bëj ndonjë mëkat.

Dhe këto pyetje që bëj unë,
Nëse i bën dhe ti për mua,
Prej teje s'dua gjë më shumë
Dhe kot tani jam i trishtuar.

IV

Si ndodhi vallë, si ndodhi,
Vec për një çast u bë gjithçka,
Pastaj jeta prap natyrshëm rrođhi
Dhe gjurmë kjo ngjarje nuk la.

Asgjë ndryshoi, vec një vakt pa ngrënë.
Asgjë nuk humba, ose fare pak
Dhe sa për fjalët e pathëna
U pendova për ato që të thashë.

Pastaj jeta natyrshëm rrođhi,
Pa dhimbje, shqetësim a mërzi,
Si ndodhi vallë, si ndodhi,
Që as emrin s'të kujtoj dot tani?

V

Emri yt është aroma e jetës,
Hapësira e saj-sytë e tu,
Nëse këtyre do u shtoja diçka tjetër,
Më mirë emrin të të shkruaja këtu.

Nëse do të shtoja të tjera tipare,
Më mirë sytë të vizatoj,
Atëherë se për kë është fjala
Natyrisht të gjithë do ta kuptojnë.

Po unë dua që kjo të mos dihet,
Madje mos ta dish as ti vetë,
Që të mbetet përgjithmonë vetëm imja
Më mirë po e mbaj sekret.

VI

Ajo nuk kthehet më tek unë
Dhe as unë më s'kthem tek ajo,
Gjithë rrugët tona u zunë,
Nuk hapen më kurrë ato.

Do kthehen ndër pyje harabelat,
Dallandyshet do kthehen në verandë,
Do kthehen vjeshtat dhe verat,
Në atdhe do kthehen refugjatët,

Do kthehet gëzimi tek njerëzit,
Ndoshta dhe tek unë një ditë,
Do kthehen gjethet tek pemët,
Do bien e do kthehen sërish,

Do kthehet dimri domosdo
Në shtratin e vjetër ç'do lumë,
Vetëm unë më s'kthehem tek ajo
Dhe as ajo nuk kthehet më tek unë.

MPOSHTJA E DHIMBJES

Plagëve nuk u'a hedh sytë.
Po t'i shihja do të më dhimbnin vërtetë.

VËLLEZËRIT SIAMEZË

Bashkë e nisën,
Bashkë e ngrysën jetën,
Fat që nuk arritën trembëdhjetën.

L...

S'i fala lule nga lulet e prillit,
I fala vjersha shkruar me gjithë shpirt,
Por nën peshën e rëndë të zhgënjimit
Edhe ato i grisa një ditë.

Se ajo ishte për të gjithë bujare,
E gatshme për të gjithë ish ajo,
Si dysheqet e ngrohtë të haneve
Mbi të cilët mund të shtrihet kushdo.

KËTU...

Së pari isha unë,
Pastaj erdhe ti,
Më pas dashuria.

Në fillim ike ti,
Dashuria diçka pas teje.
Edhe unë do iki një ditë.

Askush, askurrë s'do të kthehet,
As për tu habitur të paktën,
Sesi pakuptuar do ta kemi harruar
njëri-tjetrin.

E VONUAR

Ti je e bukur, por bukurnë tënde
Unë nuk munda ta pikas që atëherë,
Kaloja para teje hijerëndë,
Por koha iku si ta merrte era,
Kaq shpejt u rrite ti, u bëre vajzë,
Eh, për mua tashmë u bë vonë,
Se matem të të flas, por një unazë
Në gishtin tënd të bukur s'më lejon.

NJERIU KA NEVOJË

Njeriu ka nevojë për ledhatimet e nënës,
Për porositë e babait në orët e mbrëmjes,
Njeriu ka nevojë të rrisë fëmijë,
Ka nevojë të thërrasë «baba» dhe «bir»,
Ka nevojë për seriozitetin e vëllait më të madh,
Për përqafimet e motrës pas një mungese të gjatë,
Për shakatë e shokëve, debatet e talljet,
Për misterin e syve të kaltër të një vajze,
Për kartolinën e një kushërirri të largët ka nevojë
Dhe gjithashtu për «mirëmengjesin» e të
panjohurve.

NETË DIMERORE

I

Nën këngën e shiut
Më merr gjumi herët,
Nata ime—
Serial èndrrash
Me hero
Pranverën.

II

Pranverë në èndërr,
Dimër në jetë—
Simbiozë e vërtetë.

III

Rri e hesht... E ç'të bësh tjetër
I vetëm në dhomëzën e mjerë,
Ende kam në shpirt shpresën e vjetër
Mos vjen dikush dhe troket në derë.

Duke ushqyer kështu shpresën e marrë,
Ushqej veten, veten mbaj në jetë,
Veç shiu troket në dritare,
Në derë veç era troket.

IV

Natën egër fryn veriu,
Mërzia mbi trup më shëtit,
Kur ja, tani i'a mbërrin shiu
Me funksionin e tij katalistik.

Mërzia shumohet si bakteret,
Përhapet sipër trupit tim,
Para një viti në pranverë
Kështu më ndodhte me gjëzimin.

V

Mu kthye në shpirt prap gjëzimi,
Qiell i kthjellët, as shi, as erë,
Një natë si kjo në mes të dimrit—
Seancë spiritizmi me pranverën.

E PAFSHEHTË

Nuk di pse dashuria e parë
Më erdhi ndërmend ~~befasisht~~,
Pa dashur në xham të dritares
Emrin e saj shkrova me gisht.

Atë emër e pata shkruar sa herë
Në bankë e në libra padashur,
E doja fort, por asnjëherë
Nuk munda ta thirrja: E dashur!

Kjo ështëjeta.
Unë s'i mbaj mëri
Në xhamin e veshur nga bryma
Qofsh e lumtur! shkrova përbri
Emrit të saj: Adelina.

1991

Sheshi i madh-shkretëtirë e pabanuar,
Hijet e pemëve kanë mbetur të vetmuara,
Të heshtura varrezat dhe shtëpitë—
Fshati im, a do ringjallesh ndonjë ditë?

MESDITË

Nxënësit janë ende në mësim,
Për zilen e fundit në priftje,
Jashtë, ndanë rruge djemtë rrinë,
Ku kalojnë gjithmonë gjimnazistet.

Sa orë atje i kanë vrarë
Duke pritur dhe ata zilen e fundit,
Zilja bie. Më shumë se shkollarët
Gëzojnë djemtë ndanë rruge.

EDHE NË S'VJEN

Unë rri mbështetur tek një shtyllë,
Më tej në stol pushon një plak.
Ai pret vdekjen që të vijë,
Unë të pres ty të vish nga larg.

Dhe shkel me këmbë gjethet e verdha
Me sytë ngulur tej në kthesë,
Unë do të pres, po dhe në s'erdhe
Si plaku vdekjen s'do ta pres.

PAS SHIUT

Pikon çdo strehë, pikon ç'do dru,
Pasqyra pellgjesh rrugës tutje-tëhu,

Shndrit vesa mbi petale trëndafilash,
Që çelen si buzëqeshje fëmijësh,

Për të harruar shiun dhe erën
Mbi kodër lind një ylber,

Në qiellin që sërish u bë i kaltër,
Drejt jugut ikin retë si refugjatë.

KUR NGA ATDHEU NJË ERË FRYN

Zbrazëtia e karrigeve tuaja qark meje
Ma hidhëron keq kafen e mëngjesit.
Ndez një cigare
Po paketën kujt t'i'a zgjas?
Ju jeni larg mes bollëkut dhe vëtmisë...
Në fytin tim e ndjej lëmshin e lotëve tua.
Kur nga Atdheu një erë frys.

ASAJ RRUGE

Po iki, lamtumirë!

Tani në vjeshtë dhjetëfish dhemb kjo fjalë,
Tashmë zymtimi sundon mbi qiej e shpirtra
Dhe pika e shiut nga pika e lotit s'dallohet,
Po iki asaj rruge që aq shumë e mallkova.
Asaj rruge që më mori gjith miqtë, të afërmit.

Duke shkelur mbi gjethet e rëna dhe mbi

agoninë e shpresave

Po iki.

I vdes. Më mirë të vdesin. Ashtu nuk mund t'i
shoh!

Po iki, nënë e shtrenjtë, lamtumirë!

Tani në vjeshtë më tepër se kurrë

Ti do ta ndiesh mungesën time,

Me sytë mbërthyer në mjerimin e qiellit

Do përcjellesh një nga një dallandyshet që ikin,
që vijnë pas meje.

Do numërosh pikat e shiut sikur numëron plagët
e tua,

Sikur numëron hapat e mi

Asaj rruge që aq shumë e mallkove.

SHI NË DHE TË HUAJ

Erdhi një shi nga Atdheu.

S'ka gjë nën të po lagem.
Edhe dëbora po të vijë që andej
Nuk më ngrin-Do më mpiksë plagët.

Korfu, 30 shtator 1992

KTHIM

Ndoshta jo vetëm prej mjegullës
Shtëpia më duket më e plakur,
Kënga e menteshave më e përvajshme,
Më të thelluara rrudhat e babait,
Flokët e nënës më të zbardhur
Ndoshta jo vetëm prej miellit të bukës...

Lotët prej gjithë dhimbjeve kursyer
Si fëmijë i derdh këtë çast.

REKUIEM

U bë një vit që pér ty s'shkruaj asnë varg,
U bë një vit që ti muzë s'bëhesh dot,
Stilolapsit tim pér ty i ka mbaruar boja,
Tek zjarri i shuar, tek thëngijtë e tij të ftohtë.

Askush nuk mund t'i ngrohë duart. As unë...
Aty u dogjën 'embëlsia dhe ashpërsia jote,
Metaforat pér sytë e tu aty u dogjën,
Fjalët nën hi dhanë shpirt nga asfiksia
Dhe brenga u përhap si tym në ajër...

Që atëherë pér ty s'shkruaj asnë varg,
Që atëherë ti muzë s'bëhesh dot,
Unë pér një tjetër shkruaj
Dhe ti pér një tjetër èndërron.

1991

KUJTIM I SHIUT TË ASAJ DITE

Unë rri në dhomë,
Dëgjoj shira të largët,
Shira që s'lodhen e s'reshtin kurrë,
Që përplasen asfaltit e ndërtesave të qytetit,

Duke ngritur pikëla si lila të asaj dite,
Duke krijuar aty-këtu pellgje të trazuar
Prej një puhie që dy herë s'frym;
Lotojnë qiejt, të thoshja unë,
Lotonin qiejt e ne qulleshim prej lotëve.

Unë rri në dhomë,
Dëgjoj shira të largët
Dhe kam merak për ty mos çadrën ke harruar,
Edhe pse t'i duá mollëzat e përskuqura,
Edhe pse t'i adhuroj flokët e lagur,
Kam merak...
Po edhe shirat më ne s'na lagin
Për ta bëré të pakthyeshme atë ditë.

VAJZAT GREKE

Bukuria e Helenës është shpërndarë
Tek çdo fytyrë e vajzave greke,
I shihja rrugës tek shkonin krenare,
Si yjet, të largëta, të paprekshme.

Vërtet ishin të largëta, por një ditë
Të diel tek ktheheshin nga kisha,
Disa herë unë u bëra Parid
Dhe me mend i rrëmbeva të gjitha.

Dhe u thashë me greqishten e çalë:
Këtu! Nuk ka më Greqi!
U bindën, nuk thanë asnjë fjalë,
Në mendje i kam dhe tani.

Sarandë, 25 shkurt 1993

PERRALLË E VERTETË

Koha ishte shtatzënë
Dhe lindi një djall me brirë
I këndoi ninulla dhe këngë,
Se sido që ish e kish bir.

Por dihet ç'bëri djalli.
Sa la djepin
Kaloi aventura me radhë
E më në fund u ul në fron të mbretit
Dhe kohën-mëmë e vari në litar.

DIMRI I SHPIRTRAVE

Anembanë tani zunë shirat,
Njëkohësisht si me komandë gjithandej,
Vetëtimat, me sa duket, në errësirë
Rrugën dimrit i rrëfejnë.

Sa shpejt që erdhi sivjet dimri
Mbi malet, fushat, kudo,
Nga oxhaqet i zi po del tymi,
Po zjarri asgjë prap nuk ngroh

Se dimri është futur kaq thellë,
Në shpirtra ka nisur më shpejt,
Të trishtimit borën ka mbjellë,
Acarin ka ngrirë në dej.

Unë shpirtit mund t'i thoja: Prit,
Duro edhe pak deri në mars!
Stina e dimrit do iki një ditë,
Po dimri i shpirtrave vallë do ta ndjek pas?

NJË PIKEZ LOTI

Një pikëz loti sërish e mori rrugën
Nga shpirti im drejt syrit tim
Këtë radhë ta gëlltit më s'mundem,
Nëse vërtet jam burrë do e humbas burrërinë.

Iku ajo kohë kur qaja kot së koti
Dhe kisha nam si qaraman në një mëhallë,
Nëse tani jam burrë më duhet që lotit
Me burrërinë time t'i bëj ballë.

Megjithatë, gjithkush prej mishi e dejesh,
Gjithkush që pohon se është njeri,
Ta dëjë se ç'ndodh tani brenda meje
Do ma falë këtë lot kur të mbërrijë në sy.

FAQE DITARI

Viti nëntëdhjetë e dy, qershori përvëluar,
Rutinën e ditëve nuk e prish asgjë,
E nesërmja vjen nesër-për mua ka kaluar,
Një gotë që u thye, ah, nuk ngjitet më.

E nesërmja vjen nesër— pér mua ka kaluar,
Ditët çelen, ngrysen pa më falur shpresë,
Viti nëntëdhjetë e dy, qershori përvëluar,
Qielli është i kaltër, dita është e zezë.

BARDHËSI E TMERRSHME

Prej meje po mërgojnë këngët,
Po më braktisin frymëzimet,
Zot, q'mëkat kam bërë
Që më jep të tillë dënim?

Hesht stilolapsi në xhep,
(C'heshtje prej memeci!)
Letra e bardhë mbi tryezë—
E vetmjë bardhësi e tmerrshme!

16 shtator 1991

EPITAF MBI VARRIN E NJË DITE

Këtu shtrihen njëzet e katër orët
e trishtimit të sotëm
E prap kjo ditë tek e nesërmja rron.

TANI RESHTA SË ËNDËRRUARI...

Tani reshta së ëndërruari,
Iku dhe kjo vajzë,
Iku asaj rruge ku unë s'mund ta ndjek
veçse me syrin e përlotur,
Iku si një ëndërr mes gjithë ëndrrave që thura,
Për mua vdiq (Ka dhe vdekje relative)
Dhe unë mbeta vetëm duke tymosur
këtë cigare trishtimi,
Jo edhe aq për ikjen e saj,
Sesa ngaqë nuk mund ta bind veten
që dashuria dhe pabesia rrallë
shkojnë bashkë,
Por zhgënjimi prej dashurive më është
kthyer në rutinë
Dhe ikjet e vajzave që desha—
epilogë fatalë parathënë nga Zoti.
Iku edhe kjo,
Unë e kuptoj se duhet harruar
Dhe nxehem me vveteten sepse ajo kiu
Dhe prap unë s'mundem të mos i them:
Udhë e mbarë!

KUR TË KESH QARË...

Kur të kesh qarë mbi varrin tim të mjerë,
Kur ta kesh larë me lot këmishën time,
Kur gjumi netëve mos të të zerë,
Rrugëhumbur nëpër galeri kujtimesh,
Me sytë ngulur si shpresë e marrë tek dera,
Ndoshta do më presësh një natë me furtunë,
Mbi portë ngultas do trokasë era
Po ti mos e hap portën se s'jam unë.

SHTËPIA E FËMIJËRISË SIME

Unë s'rroj më atje.
Kujtimi i saj ma bën më të tmerrshme
Vetminë.

A.K

U rrëzova duke rendur pas një xixëllonje
nëpër natë...
Dhe s'mu përgjakën gjunjët,
Shpirti mu përgjak.

KUR TË VIJË VJESHTA

Kur të vijë vjeshta mes shiut të imtë
Do shkoj unë strukur nën ombrellë,
I vetëm një dialog të pakuptimtë
Do ndërroj me natën e thellë.

Diku larg ti ulur pranë zjarri
Erën do dëgjosh tek zu të qajë,
Vajtimin e saj në dritare,
Ndërsa heshtur do punosh mbi pajë.

Në tu kujtofsha unë atë natë,
Do pyesësh veten: — Vallë ç'të jetë bërë?
Në vend të përgjigjes padashur
Gishtin do shposh me gjilpërë.

Ndërkaq në një rrugicë shiu i imtë
Pareshtur nëpër natën e thellë
Një këngë krejt të pakuptimtë
Dhimbshëm do këndoja mbi një ombrellë.

MOS QAJ

«Që ty të shajnë, fajin s'e ke ti,
A s'është shpifja shenjë e bukurisë»

SHEKSPIR

Mos qaj! Mbi qerpikun e zi lotët
Dhe qiellit të syve përskaj
Kanë fugi të trishtojnë gjithë botën
Dhe njerëzit dhe drurët... Mos qaj!

Mos qaj! Nga të gjitha dënimet
Më i rrepti pafajësisë i përket,
Ky është një ligj, të cilit i bindet
Gjithkush që mbi këtë rrizuull ecën.

Mos qaj dhe mos e thërrit vdekjen,
(Ajo na pret të gjithëve një ditë!)
Të lutem, krijo një buzëqeshjë
Që ligësisë t'i verbohen sytë!

NJË MALL

Ende pa klithur e para makinë,
Befas si rrallëherë më doli gjumi,
Më ish bërë në èndërr i miri fshati im
Me shtëpitë me gurë e sokakët me gurë.

Pa kënduar gjeli, dita pa u gdhirë
Një kollë e vjetër ndihet në sokak,
Me kërsëllimë hapet një dericë,
Nga ku del një lopë dhe pastaj një plak.

Dhe unë ngrihem herët, vrapij në korije,
Me hapin tim fluturak, të marrë,
Tek një rrënjez e dalë pengohem dhe bie,
U bë kaq kohë gjunjët pa i vrapë.

Aty rreth mesdites befas nis një shi,
Shiu i 20 majit të atëhershëm,
Si dikur i ndrojtur putha përsëri
Të parën mikeshë tek Fiku i Egër.

Nuk na pa kush. Rruga ish e shkretë,
Me ç'do pikë shiu sekretin tonë e ndamë,
Vetëm në muzg, si mbaruan kafetë,
Plakat na pikasën tek filxhanët...

U zgjova. Mikja, sokakët dhe shtëpitë
Janë larg, në një pikë të paarritshme,
Në zemrën time hapet një derickë,
Nga ku del një mall dhe vrapon për në
vendlindje.

KURRË

...Do e thyej stilolapsin, fletoren do e gris,
Die do i them lamtumirë poezisë.

